



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 112, datë 06.03.2024**

**PËR**

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}  
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË  
GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR POZICIONET  
E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR.  
244, 246, 247 DATË 24.05.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN  
E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË  
KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 06.03.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatit, z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 244, 246, 247 datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

**VËREN**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Me Vendimin nr. 244, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.*

2. Me Vendimin nr. 246, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.*

3. Me Vendimin nr. 247, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.*

4. Në këto procedura të ngritjes në detyrë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, afati i kandidimit është përcaktuar deri më datë 14.06.2023. Kjo procedurë është shoqëruar me njoftimin përkatës dhe publikimin e vendimeve respektive të shpalljes së vendeve të lira dhe hapjes së procedurës së ngritjes në detyrë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

5. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

6. Me Vendimin nr. 57, datë 07.02.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ndër të tjera ka vendosur:

*“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*2. Caktimin e relatorit si më poshtë: 16. Për kandidatin z. {...} - relator z. Klodian Kurushi.”*

7. Më datë 12.02.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Më datë 19.02.2023, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidati duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 11.03.2024, pranë ILDKPKI-së.

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidatin z. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

12. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

13. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimin e tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbjlljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidatin {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

13.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 22.02.2024, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

13.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës – sa i përket stazhit profesional (*tashmë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës*), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë (*tashmë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të*

*Përgjithshëm Fier*) dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ( *tashmë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*). Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë informacioni i kërkuar është përcjell elektronikisht më datë 23.02.2024 siç do të përshkruhet më poshtë; nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier informacioni është përcjellë nëpërmjet postës elektronike më datë 22.02.2024 siç do të përshkruhet më poshtë.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT**

### **14. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.**

15. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

16. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës civile për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023.

17. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2001, ndërkohë është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për periudhën 15.09.2000 deri më 02.10.2001, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile si dhe çështje penale. Në vijim, ai është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku gjatë periudhës shkurt –tetor 2008 ka ushtruar funksionin e Kryetarit të Gjykatës. Në këtë gjykatë detyrën e ka ushtruar deri më 20.12.2013. Më pas është transferuar në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë ku vijon të ushtrrojë funksionin. Në periudhën 2011-2016 ka qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

18. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 18.07.1998, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2001 dhe ka përfunduar Master i Nivelit të Dytë në Shkenca Penale në Universitetin e Tiranës në vitin 2012.

Me dekret nr. 2742, datë 15.09.2000 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me dekret nr. 3111, datë 02.10.2001 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Me vendim nr. 187/3, datë 03.02.2006 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë delegohet për të kryer përkohësisht detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datë 18.10.2006.

Me vendim nr. 419, datë 20.12.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me Vendim nr. 276, datë 06.05.2011 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, realizohet procedura e verifikimit të ligjshmërisë së mandateve të Anëtarëve të rinj të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përfshirë edhe Z. {...}, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datë 08.04.2016 dhe në vijim ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendim nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 23 vite.

Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

**19. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë.**

20. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidati ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në fushën civile pranë gjykatave të sipërpërmendura për një periudhë të paktën 5 vjet.

21. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton që kandidati prej vitit 2013 është pjesë e dhomës civile.

22. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, sipas urdhrave për ndarjen e gjyqtarëve në dhomë/seksione dhe trupa gjykues për vitet 2000 - 2013, rezulton se:

- Për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve pranë kësaj gjykate nuk ka pasur ndarje në dhoma penale apo civile. Çështjet penale janë shpërndarë me short ndërmjet gjithë gjyqtarëve, ndërsa për çështjet civile do të ketë ndarje në seksione. Konkretisht nga urdhrat e Kryetarëve të gjykatës së rrethit gjyqësor Lushnjë, të përcjella për periudhën 2000 - 2013 ka rezultuar se: kandidati në vitin 2002-2003 ka qenë pjesë e seksionit administrativ; në vitin 2004-2005 ka qenë pjesë e seksionit tretar; në vitin 2006 ka qenë pjesë e seksionit familjar, në vitin 2007 pjesë e seksionit tregtar dhe civil të përgjithshëm; në vitin 2008 ka gjykuar në seksionin tregtar; në vitet 2009-2010 gjithashtu në seksionin tregtar; në vitet 2011-2012 pjesë e seksionit familjar. Sipas urdhrat nr. 4 prot, datë 04.01.2013 të Kryetarit të Gjykatës së rrethit gjyqësor Lushnjë, -për vitin 2013-2014 gjyqtarët e

kësaj gjykate do të gjykojnë të gjitha llojet e çështjeve, pa ndarje në Dhomë Civile (çështje civile, tregtare, administrative familjare) dhe Dhomë Penale.

**23. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, rezultojnë të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.**

**24. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.**

25. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”.

26. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 13.06.2023, nëpërmjet të cilëve, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk kam masa disiplinore në fuqi*”.

27. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

**28. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masa disiplinore në fuqi.**

**29. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.**

30. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për atë që është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë*”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “*Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë*”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “*Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni*”.

31. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 13.06.2023, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

32. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

**33. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.**

### **III. KONKLUZIONE**

34. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve nr. 244, 246, 247 datë 24.05.2023, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të kriterëve formale të kandidimit të z. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

35. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak kriterëve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. Drian {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore në procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 244, 246 dhe 247 datë 24.05.2023.

### **PËR KËTO ARSYE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4 të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në shkronjën “a” të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 47, në pikën 7 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 244, 246, 247 datë 24.05.2023; “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i tij, z. Klodian Kurushi,

## **VENDOSI:**

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**